



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

Procesverbal 08/2026

I Mbajtur në takimin eV-të të rregullt të KK-së me datën 31.07.2026, në sallën e Kuvendit në ora 10:00 nën kryesimin e Kryesuesit të KK-së, Xhavit Zariqi, në prani të anëtarëve të saj, OJQ-ve dhe Zyrtarës për informim.

Fjalën Hyrëse – Kryesuesi të KK-së, Xhavit Zariqi;

Rendi i ditës:

Nëse jeni gati, a mund të fillojmë?

Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Të nderuar anëtarë të kuvendit të komunës së Ferizajit, të nderuar drejtarë, media, shoqëri civile, mirë se keni ardhur në mbledhjen e rregullt të tetën me radhë të kuvendit të komunës së Ferizajit. Për këtë mbledhje në bazë të materialeve që keni marrë propozojmë këtë rend dite:

1. Konfirmimi i pjesëmarrjes në mbledhjen e KK-së;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të KK-së;
4. Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Ferizajt për vitin 2025;
5. Raporti financiar për periudhën Janar – Qershor 2026
6. Propozim-Vendim për Shpalljen Interes i Përgjithshëm të ngastrave kadastrale 678-1, 678-2 Z.K.Talinovc i Jerlive;
7. Propozim-Vendim për Këmbimin e pjesëve të ngastrave kadastrale: 320-0, 321-2 dhe 308-6 Z.K.Talinovc i Jerlive, prona private, me pjesën e ngastrës kadastrale 459-1 Z.K.Talinovc i Jerlive, pronë e Komunës së Ferizajt;
8. Propozim-Vendim për Shpalljen Interes i Përgjithshëm të ngastrës kadastrale 100-1 Z.K.Ferizaj;

9. Propozim-Vendim për aprovimin e Rregullorës për Taksa Komunale;
10. Propozim-Vendim për miratimin e plotësim-ndryshimin e Strategjisë për zhvillimin dhe fuqizimin e rinisë në Komunën e Ferizajt 2024-2029 dhe Planit të Veprimit 2024-2027;
11. Propozim-Vendim për bashkëfinancim me GLV “Bifurkacioni”;
12. Propozim-Vendim për ngritjen e tarifave, ndryshimi të Rregullores 01.Nr.124 për Parkingjet Publike në Komunën e Ferizajt;
13. Propozim-Vendim për miratimin e Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Ferizajt;
14. Pyetje dhe kërkesa;
15. Të ndryshme.

Në komitetin për politikë e financa e kemi pasur edhe një pikë për të cilën jemi pajtuar me e fut në rend ditë se që është rishqyrëtim i vendimit numër 51 i datës 30.04.2026 që bëhet fjalë për plotësim ndryshim të një vendimi që e kemi marrë paraprakisht për komisionin për ankesa në rastin e dhënies së pronave shfrytëzim.

A ka dikush rreth rendit të ditës ndonjë çështje?

Kush është për miratimin e këtij rendit të ditës?

38 për.Faleminderit. A ka kundër? Jo. Abstenim? Jo.

Sa i përket rendit të ditës, unë dua t'ju njoftoj që e kemi një kërkesë e të cilën unë jam i obliguar me e qit në kuvend. Nëse kuvendi e miraton, pastaj vazhdojmë me procedurë të rregullt. Kërkesa është për shqyrtimin e vendimit lidhur me kompensimin e pronës së liruar për interes publik, ndërtimin e nënkalimit në fshatin Nekodim. ë siç e dini pra është marrë prona për ndërtimin e atij nënkalimi dhe tani firma ose kompania dakon kërkon kompensim për lejimin e ndërtimit të objektit publik që të gjithë e dimë që është i ndërtuar, ka kërkuar me e qit në rend dite me e shqyrtu dhe me marrë vendim për kompensim të pronës me lejim të lejes së ndërtimit për objektet përkatëse në qytet aty te SDK-ja qysh me i thënë te bankat te ATK-ja kush është që të futet në rend dite kjo kërkesë a po numëron të lutem 17 për Faleminderit. Kush është kundër? 11 kundra. Dhe një abstenim. Faleminderit.

Vazhdojmë me rendin e ditës. Pra, sa i përket konfirmimit për pjesëmarrje, nuk kam ndonjë paralajmërim. Miratimin e rendit ditës së kryëm. Pika tre, miratimi i proces verbalit të mbledhjes së kaluar të kuvendit të komunës.

A ka dikush ndonjë vërejtje në proces verbal?

Kush është për miratimin e procesverbalit? 38 për.

A ka kundër? Jo. Abstenim? Jo.

Pra të gjithë vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës. Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të komunës së Ferizajit për vitin 2025.

Drejtoreshë e keni fjalën.

Sebahate Ajeti Sadiku.

Faleminderit kryesues. Përshëndetje për të gjithë pranishmit. Është raporti i pasqyrave financiare për vitin 2025 tashmë veç ka përfunduar dhe ne na ka ardhur raporti përfundimtar. Opinioni i mendimit të raportit të auditimit është opinioni i kualifikuar me theksim të çështjes. Përkundër kësaj, ne kemi dërguar edhe një plan të veprimit për implementim të gjetjeve të auditorit. Kështu që mendoj se nëse keni debat diçka, ne jemi këtu he për t' dhënë përgjigjet edhe pse kemi dërguar përgjigjet në ZK.

Faleminderit.

Dëshiron dikush diskutojë rreth raportit financiar?

Urdhëro Ibrahim Osmani.

Faleminderit kryesues. Të nderuar drejtorë të drejtorive, të nderuar anëtorë të kuvendit, të dashur shtetorë të Ferizajit. Fillimisht dua të theksoj se sot e kam dashur kryetari i komunës me ardhë këtu edhe me i mbrojt këto të gjeturat të cilat për keqmenaxhimin e keqpërdorimeve të detyrës së tij e ka bërë gjatë tërë vitit 2025 dhe sot nuk vjen për me diskutuar për këtë raport të auditimit. Pra kur po hyjmë të diskutimet këtu ç ka gjetur raporti i auditimit e shohim që ka keqmenaxhim kur po e diskutojmë te të gjeturat pra ç ka dashur çarë ka bërë komuna e Ferizajit edhe ky ekzekutiv këtu bashkë me kryetarin Him Aliu shihet qartë që ka keqmenaxhim të këtij buxheti të keqpërdorimit. Pra, komuna e Ferizajit ka lidhur gjashtë kontrata me vlerë mbi 500.000€ për të cilat nuk kishte bërë njoftim paraprak siç kërkohet me rregullat e prokurimit publik. Në tre raste është konstatuar se komuna ka hyrë në obligime kontraktuale pa siguruar fonde të mjaftueshme financiare në kundërshtim në ligjin për ndarje të buxhetorit.

Pra, komuna ka inuar procedurat e prokurimit pa asnjë projekt detaj.

Pra, ka bërë pagesa të realizuar me furnizime punë të cilat nuk kanë qenë të përfunduar në tërësi. Ndërsa në dy raste pagesat për investime kapitale janë paguar nga buxheti i projekteve kapitale jo përkatëse që i bie që as nuk ka marrë vendim nga kuvendi komunal por drejtoria e financave ka bërë pagesa pa bërë pa e pruar në kuvend komunal që i b keqmenaxhim nga drejtoresha e financave. Pra në 89 raste komuna e Ferizajit ka faturat janë kryer me varesë e projekteve që i bie duke tejkaluar afatin ligjor prej 30 ditësh. Pra nuk të bëjë kontrata kolektive siç është thirrë kryetari i komunës së Ferizajit që po ja merr buxhetin, por është keqmenaxhimi e keqpërdorimi i projekteve në komunën e Ferizajit.

Pra, në dy raste ishte bërë subvencionimi i oj-q-ve dhe fermerëve jo në pajtim me kriteret e thirrjes publike që kanë bërë këta. E në anën tjetër kur i kemi te projektet të cilat këta janë thirrë i bjen që për shpenzimet që i takojnë kategorisë së pagave dhe medijëve e që kanë të bëjnë për pagesat e kontrollës kolektive të arsimit janë paguar 4.548.000 e jo siç thirret kryetari 17 milion.

Edhe këto pagesa janë bërë nga investimet kapitale dhe nga mallat e shërbimit. Në anën tjetër komuna për vitin 2025 ka nënvlerësuar detyrime kontingjente në shumën prej 140.000 € sipas dokumenteve burimore po vlera reale e këtij detyrimi ishte 294.000€ pra 146.000€ njëherë nuk i ka treguar hiç tjetra prezantimi jo i saktë i detyrimeve të papaguar sipas planit financiar vjetor komuna ka nënvlerësuar obligimet e papaguar të raportit në planin financiar financiar vjetor në vlerë prej 127.000€ pra komuna nuk i kishte raportuar detyrimet e papaguara në vlerën prej 105.000€ për pagesat e punonjësve të cilët gjatë vitit 2025 ishin përfshirë në listën e pagave. Ndërsa për këta punonjës pagat janë kthyer në mënyrë retroaktive për periudhën pas përfshirjes në listë. Pra i bie që edhe te drejtoria e arsimit ky drejtor këtu nuk ka bërë listën tamam të saktë e që i b që edhe këtu ka keqpërdorur me pozitën e tij bashkë me me stafin e tij që i b që këta kanë shtuar numër duke mos i fut në listën e pallave duke pas edhe konkurs të rregullt publik e në anën tjetër për shembull i ke gjashtë kontrata nga 500.000€ që kanë lidhur. Për çfarë kanë bërë këto?

Ritenderimi për qendrën multifunktionale në Ferizaj me vlerën prej 3.298.000€ e kanë bërë pa procedura të prokurimit publik. Pra edhe në vlerën që e ka financuar ministria, por këta që e kanë pas për me mirëmbajt evidencën dhe punën e ritenderimit e projektin nuk e kanë bërë ashtu qysh duhet. E në anën tjetër edhe po rrugën Ferizaj Pleshin nuk kanë pasur prek fare dhe e kam futur në buxhet. Pra prej vlerën prej 2.899.000€ të paktën kish pasur prokurori funksionale. Ky raport është ai që tregon që ky ekzekutiv bashkë me kryetarin e komunës ka dashur me dhënë përgjegjësi në prokurori, por disa prej ty janë edhe sot këtu te ne. Krejt s'po e sheh se s'po e sheh kryetarin këtëzka thirrë unë nuk është që kam vdes me diskutu shumë sepse 21 gjetjet e adytimit që kryetari vetë i ka pranuar që ka keqmenaxhim me keq shpërdorim të buxhetit kanë dashur me ardhë me mbrojt këto po meqënëse nuk është kryetari këtu këtë raport kemi me diskutuar të vitin sivjet derisa të vje kryetari këtu edhe me i thënë që a po pajtohesh që me miliona e miliona euro je du i çuar Du u bë keqmenaxhim e tu thirrë që kontrata kolektive po i merr paret që i b që nuk është e vërtetë se më shumë se 60% të këtij buxheti që thirrë kryetari ja ka marrë vetëm keqmenaxhimi për projektet që e kanë bërë e që i bie drejtoria tjetër është drejtoria e përmbaruesit që ndoshta dhe kryetari i vet mundet me bashkëpunu me ta. Ju faleminderit shumë. Kryesuesi i kk-s Faleminderit dikush tjetër.

Urdhëro, Visar Azemi

Faleminderit kryesues, të nderuar kolegë. Është nuk mundet me kaluar një raport i auditimit pa u diskutuar mirë në këtë kuvend dhe pa i nxjerrë të gjitha gjetjet të cilat i ka evidentuar ky raport, sepse nuk janë thjesht gjetje të opozitës, por janë gjetje të një institucioni kredibil, i cili nuk anon. Pra është shqetësuese me i parë se si paratë publike të qytetarëve janë menaxhuar dhe janë keqpërdorur përgjatë këtij viti. Pra ka një varg shkeljesh dhe ky raport sigurisht që është raport i kualifikuar dhe i nxjerrë të gjitha në pah. Po i përmendi disa prej tyre. Po flasim për afër 8 milion euro të cilat janë shpenzuar në kategori të gabuara buxhetore. Pra çfarë domethënë paret prej një kategorie që janë destinuar për një diçka tjetër i keni marrë dhe i keni çuar në një investim apo shpenzim tjetër. Pra e papranueshme, e patolerueshme sepse po flasim për 8 milion euro të buxhetit të taksapaguesve të qytetit tonë në Ferizaj.

Po flasim për gjashtë kontrata milionshe pa njoftim paraprak. Prapë po i referohem raportit të auditorit. Gjashtë kontrata pa njoftim paraprak. Domethënë që ti nuk i ke përfillë procedurat e tua të brendshme për me tregu se ku ke me i çu me shpenzu këto pare dhe këto shifra janë shifra milionshe. Prap para të taksapaguesve të qytetarëve të Ferizajit. Janë nënshkruar kontrata pa mbulim financiar. I përmendëm edhe pak më herët. Vetëm tre projekte që janë përmendur aty e

kalojnë shifrën 1.1 milion euro, kontrata që janë marrë para prejve që ish dashur me u realizuar në të ardhmen. Pra nuk i keni paraparë në asnjë buxhet dhe ato para sigurisht që kanë me mungu për investimet në të ardhmen. Këni dhënë tender pa e punuar projektin fare. Pra s'është punuar projekti. Nuk dihet çfarë ka me ndërtu. Nuk dihet sa ka me kushtuar, nuk dihet cilat janë implikime të tjera, veç i keni kryer procedurat dhe i keni dhënë kontratat.

Janë 89 faktura të paguara me vonesë. Edhe këto përveç kostove që i kanë pasur kanë pasur edhe kosto shtesë të procedurave gjyqësore dhe përmbartimore. Ju e dini që qyteti i Ferizajit, komuna e Ferizajit është në kollaps buxhetor për shkak të parave që ju kanë marrë prej përmbartuesit dhe e keni pas të qartë çka ndodh? Pse me pru edhe njëherë punën për me u përballë me këto procedura përmbartimore. E dimë që shuma milionsh janë tu përfunduar sot tek përmbartuesit privatë dhe unë kërkoj i nderuar kryesues, të dashur kolegë që dikush me pas përgjegjësi për të gjitha këto gjetje nga ky raport i auditorit.

Kërkoj një shpjegim se cilat masa janë marrë deri sot nga këto gjetje dhe ç do të bëhet më tutje dhe për bes kush ka me dhënë llogari e përgjegjësi për këtë dëm financiar që ka shkaktuar komunës tonë. Faleminderit shumë.

Kryesuesi - Faleminderit kryetar.

Tjetërkush, urdhëro Xhevat Sallhu,

Sa sa i përket auditorit të jashtëm gjetjet që ka bërë mua në më interesuar edhe me vërtetu këtë çështje. Një rast e kemi faqe 10 asfaltimi i rrugës kryesore zllatar edhe asfaltimi i rrugës kryesore zllatar tretarit deri te shkolla. Edhe ne e kemi një gjendje që e ka marrë kompani një kompani këtu e Ferizaj që nis rrugën. Kjo është gjendja që komuna s'ka shti pare gypa. Një shi me ra e ka prishur bazën komplet. Kam shku e kam nxjerrë kontratën se mos të vij këtu ta po kam t'i nxjerr dëshmitë. Këto janë kontrata që kanë nënshkruar komuna që i kam nxjerrë në ministri. Edhe këtu e shoh që veç 50 m gypa i ka shti. Edhe nuk është gypa hiç. Po më e keqja që është këtu që prej këtij memorandumi, prej këtyre mjeteve komuna jashtë ligjit ka bërë që ka shkuar, ka shtruar rrugë gica në Pojat edhe në fshatra të tjera. Edhe ka hap këtu kontratë këtu. Këtu me dëshmi kam gjet me falte të gjalla. Janë rrugët në fshatin Dardani Pajatë Mirash. Mirosaj, ne në emër të projektit të vlatlit edhe kjo kjo është tmerr çar kan me bërë edhe kjo kjo më vjen keq se kam ng dy vjet për këto projekte edhe tash gjatë muajit ke bërë he me ardh me t'i lënë rrugë të keq mos me të pru as gypa e me parë të këtij projekti me shku me shtru rrugica nëpër të tjera fshatra kjo.

Kryesuesi-Faleminderit Xhevat. Dikush tjetër?

Urdhëro Arian Imeri,

Faleminderit kryesues. Përshëndetje për të gjithë. Atëherë të nderuar anëtarë të kuvendit. Para vetes kemi raportin e auditimit. Zakonisht si anëtarë të kuvendit nga opozita në këtë pikë për shkak që është audituar puna e ekzekutivit, këta janë këtu dhe e mbrojnë secili punën e vet. Nuk ka kuptim me pretenduar unë apo dikush nga kolegët tanë që e di më mirë. se drejtori i drejtorisë përkatëse punën e vet. Prandaj ju japim zakonisht hapësirë këtyre me fol, mirëpo edhe juve nga opozita nuk ju shkon me interpretuar raportin e auditimit më keq se e ka nxjerrë auditori, njerëzit profesionistë të kësaj pune dhe nuk besoj që ata e kanë kursyer komunën e Ferizajit që jo me shtu diçka. e pat që edhe mungesën e një certifikate të bashkësisë familjare e kishin paraqitur si gjetje. Pra kjo tregon me sa më si e kanë audituar punën e komunës sonë dhe kanë dhënë opinionin që e kanë dhënë të cilin mundemi me diskutu edhe sa i përket gjetjeve që kam prezantuar mirëpo po e marrim si është.

Prandaj kam vërejtje në qasjen tuaj sepse të njëjtin raport të auditimit e kemi te dy palët. Te raportet e auditimit janë dy opinione bazë për një raport të auditimit. Është opinionin i

pamodifikuar që llogaritet që është raporti i mirë i auditimit ku pasqyrat financiare janë të sakta dhe në përputhje me ligjin dhe raporti i modifikuar ku pasqyrat financiare përmbahen gabime dhe paragregullësi materiale. Mirëpo ky opinion jo i rregullt i auditimit nëse më lejohet kështu me emërtuar, i ka tre kategori. Opinioni i kualifikuar ku është edhe raporti i auditimit të komunës së Ferizajit që llogaritet që nuk është mirë raport financiar mirëpo në kategorinë e dytë edhe e tretë ku po doni ju me pozicionu. Unë jam për me marrë seriozisht vërejtje të auditorit. Kur e marrim seriozisht fillimisht e lexojmë mirë, e interpretojmë ashtu si është dhe jo me dramatizuar apo me hiperbolizu gjërat. Po ashtu si janë ajo vërejtje që është është dhe duhet me bërë përpjekje që me u përmirësu. Ne po e dimë situatën financiare në komunë dhe kjo vërehet çdo herë. Kjo në një farë forme po ndikon në raport e auditimit.

Nëse e shikojmë raportin te faqja tre, pra baza për opinion të kualifikuar, pra tregon bazën pse është dhënë ky opinion i auditimit, problemet kryesore që ndodhen janë për shkak të borxjeve dhe pra kemi pagesa të kategorive të ndryshme nga kategori të ndryshme të buxhetit. Pra nuk i kemi marrë ne 8 milion dhe i kemi dërguar dikund tjetër, mirëpo qytetarët i kanë fituar rastet gjyqësore dhe përparuesi nuk na vet as neve si kuvend dhe i bart mjet. Pra kjo është një prej problemeve që ndodh për shkak të borxheve financiare që i kemi si komunë të cilat i diskutojmë. Vlera e detyrimeve kontigjente nuk ka qenë e saktë. Ata që i dinë çka janë detyrimet kontigjente është problem i qëlluar cilido institucion sepse varur nga vendimet gjyqësore që pa ndodhur ato vendime askush nuk e di sakt sa kanë me qenë detyrim. Prezantimi jo i saktë i detyrimeve të papaguara që kryesisht lidhet me angazhimin e stafit arsimor e tha dhe kolegu. Pra gjetjet kryesore që kanë ndikimin më të madh në bazën e opinionit lidhet me problemin e borxheve. diçka që po e dimë ku e ka burimin, mirëpo nuk po mundemi me kalu.

Është një problem që e kanë të gjitha komunat e Kosovës. Kjo vërejtje derisa të paguhet të gjitha borxhet ka me u përsërit edhe te ne edhe te të gjitha komunat e K e Kosovës. Kemi pengesë, kemi pagesat e përmbarimeve dhe procedurave gjyqësore rreth 1.6 milion që lidhen shumica me borxjet e domethënë të kësaj kategorie e përmend edhe raporti. Prandaj nëse e bëjmë një interpretim të mirë të raportit të auditimit, raporti i komunës tonë është te kategoria e parë e raporteve jo të rregullta dhe arsyeja kryesore pse e kemi këtë opinion e thotë edhe raporti i auditimit del që nuk është përgjegjësi drejtpërdrejtë e nivelit komunal, mirëpo pasojat po i bartemi ne. Sa i përket gjetjeve materiale edhe ekzekutivi i ka arsytime e veta dhe besoj që drejtorët i japin arsytme, mirëpo në përgjithësi nuk janë gjetje të nivelit që doni me i paraqit vetëm përmes titullit. Auditori në momentin që e gjen një gjetje e paraqet si një veprim jashtë rregullave, mirëpo duhet me pa he përmbajtje që për shembull e kemi komuna kishte lidhur gjashtë kontrata me vlerë mbi 500.000€ për të cilat nuk kishte bërë njoftimi paraprak siçkohet me rregullat e prokurimit. E përmend edhe ju edhe mënyrën që e përmendët ju që po e përmendni unë qysh është. Pra nuk flitet për mosrespektim të procedurave prokurimit flitet për projekte të cilat nuk kanë hy në planifikimin e prokurimit.

Zakonisht kur bëhet buxhet, kur planifikohet buxheti, ë do të thotë mendohet cilat pare kanë me shkuar në projekte të cilat kërkojnë do të thotë involvimin e procedurave tenderuese dhe zakonisht në këtë rast bëhet një planifikim i prokurimit. Prandaj secili prej këtyre projekteve ka dalë, ka qenë në, ka qenë do të thotë është janë respektuar rregullat e prokurimit publik kanë qenë transparente, kanë aplikuar disa ë do të thotë operatorë dhe nuk flitet për ato qysh e thatë ju që nuk janë përfillë asnjë prej procedure. Në tre raste është konstatuar se komuna ka hyrë në obligime kontraktuale pa siguruar fonde të mjaftueshme financiare në kundërshtim me ligjin për ndarjen buxhetor. Është e vërtetë si gjetje, mirëpo do të thotë projektet janë përfund janë lidhur me ministri të caktuar, janë në përfundim e sipër. Do thotë pjesa që ka mbetur komunat mund me

me do të thotë me plotësu me buxhet vitet e ardhshme. Me rëndësi projektet janë kryer dhe mendoj që përfitimi i komunës është më i madh sesa do të thotë gjetje një gjetje auditorit. Komuna kishte iniciuar procedurat e përkrimtit pa një projekt detal ekzekutiv të ndërtimit. Do të thotë e ka sqaruar edhe drejtori këtu kryesisht bëhet për do të thotë fjalë për rrugica të cilat e dimë që pak a shumë e kanë nuk kanë nuk kërkojnë ndonjë planifikim detal. Ë në dy raste pagesa për investime kapitale janë paguar nga buxheti i projekteve kapitale jo përkathëse. Kjo do të thotë po dihet do të thotë po ndodh për shkak të problemeve të borxjeve. Me këtë rast do të thotë me rastin e pagesës është është evituar në një farë forme do të thotë me shkuar në procedura të prokurimit apo gjyqësore. Në 89 raste pagesat e fituara janë kryer me vonesë duke tejkaluar afatin ligjor prej 30 ditësh. Edhe këta po e dinë problemi kryesor prap kë janë borxhet përderisa janë marrë parët në atë fond që kanë qenë dediku përë këto 89 raste janë pagu më vonë besoj që mirë ka qenë që ekzekutivi prap ka arrit me sigur fund pagu. Faleminderit shumë.

Kryesuesi- Faleminderit Arian. Dikush tjetër? Urdhëro Visar Azemi.

Një replikë të vogël.

Faleminderit kryesues me Arjanin tash pak sepse tha opozita po reagoni pa bazë po pikërisht në këto pika që i përmendë pak po më duket koleg Arian kshinë ngut me fjalim që e ke shkruar më herët. Ë, komuna kishte lidhur gjashtë kontrata me vlerë mbi 500.000 euro, të cilat nuk ishin bërë njoftimi paraprak, siç kërkohet me rregullat e prokurimit publik. Nuk po thotë për planifikim, po thotë për njoftim paraprak. Pra janë rregulla të cilat i përcakton ligji dhe të cilat nuk janë përfillë. Në tre raste është konstatuar se komuna ka hyrë në obligime kontraktuale pa siguruar fonde të mjaftueshme financiare në kundërshtim me ligjin. Pra, këtu është thyer ligji, këtu nuk është respektuar ligji. Prandaj është vepër të cilën unë ndoshta me Arianin dhe me juve disa prej juve mundemi me pas botëkuptime ndryshe me i kuptu ndryshe por unë po dua me e bazuar diskutimin tim tek raporti i atyre të cilët janë të thirrur për me shkruar raporte financiare dhe te pika e tretë për procedurat e prokurimit pa një projekt detal detal ekzekutiv po më vjen keq po asnjë mëter rrugë nuk mundet me ushtru nëse nuk ka projekt. Pra nuk mundet me u kryer projekt, me u realizuar projekti tani me u kthyer, me bërë projektin detal ekzekutiv.

Ëh, mendoj që këto gjetje janë serioze, janë shkelje serioze, është opinionimi i kualifikuar i auditorit dhe duhet të jemi realë, t'i pranojmë faktet sepse aty ku e keni mirë unë kam me u çu dhe me ju thënë mirë e keni, kur është keq duhet me tregu që është keq. Prandaj ë mendoj që duhet me pas kujdes edhe se si i shohim gjërat, por dhe si diskutojmë me njëri tjetrin këtu.

Kryesuesi - Faleminderit kryetar .

Urdhëro Amir Rexhepi.

Faleminderit kryesues, të nderuar kolegë, drejtorë, shoqëri civile, media. Më nxiti kolegu Arian me dalë me diskutu për këtë dokument mjaft të rëndësishëm. Unë nuk e di a e ke lexuar po thotë shumë qartë. Nuk është opinion i modifikuar, po opinion i kualifikuar që me ta thjeshtësu ty dhe të gjithë të tjerëve i bjen i keq. A po kupton tash qysh ka hy komuna në borxh Arian? E di se s'mundh me arsyetu. Hajde më herët jeni arsyetuar që është trashëguar borxhi. Po këto borxje i ka bërë Agemaliu me drejtorët e tij. përmbaruesi normal që merr se tashti së fundi ju ka thënë operatorëve shkoni çoni lë në përmbarues vetë s'ka mundësi me i pagu. Ë pse janë krijuar këto borxje janë krijuar për shkak të keqplanifikimeve domethënë nuk mundesh ti me nënshkru kontratë 3 milion që bëjnë këta iniciimet me 20.000€ euro. Normal që ai operatori ka me çu lëndën përmbarim edhe me i marrë paret e tani komuna ka me hy në borxje edhe ka me dalë në

raport të auditorit. Sa për informacionin tënd, zyra kombëtare e auditimit është institucion i pavarur, është mekanizëm mbikëqyrës, jo veç komunën e Ferizaj, krejt komunat i mbikëqyr ai. A e din? Edhe unë e kam pritur singërisht që komuna ka me u angazhu që me e ul numrin e gjetjeve. A po kupton? Po. Fatkeqësisht nuk po shohim përmirësim. Dhe kjo do të duhej që të ishte angazhimi i juaj si pozitë në mënyrë që të ndikoni në uljen e gjetjeve të auditorë se vazhdimisht çdo vit ka gjetje të shumta. Faleminderit.

Kryesuesi-Faleminderit urdhëro Arian Imeri.

Faleminderit shoh koleg. E para raporti është i modifikuar se ndoshta nuk e kupton. Do të thotë raporti i pamodifikuar është raport i rregullt financiar, ndërsa raporti i pamodifikuar do të modifikuar realisht është ky që është këtu. Mirëpo unë thashë që raporti i modifikuar i ka pastaj në tre kategori e kjo është kategorinë e parë e nuk është kategorinë e dytë ose tretë. Faleminderit.

Kryesuesi-Faleminderit. Urdhëro Brahim Osmani,

Faleminderit kryesues. Qe po ja bëj një pyetje Arianit edhe po ja bëj drejtorit të bujqësisë kriterin që ke qit për me përfituar ata pllogjtu a e ke qit ti? A e ka qit auditori? Se tha raporti auditori e ka gjet gjetur kriteret. E ka qit drejtori. Po po t ceki dy që çfarë ka bërë komuna. Pra në projektin për rregullimin e shëtitores rreth shtratit të lumit nga ura e Duit deri te ura e islamit janë shfrytëzuar mjetet për pagesë prej projektit mirëmbajtja dhe rregullimi i rrjetit të ndrihimit publik Ferizaj, Komogllav, Greme, Dardani, Nerodime, Bibaj, Mirosal i ka heq paret, e ka bërë projektin në Dremjak. tjetra çfarë ka bërë është në nëntë raste menaxherët e projekteve nuk kanë përgatitur as planin për menaxhimin e kontratave. Ndërsa te tjetra për shembull ç e keni në projektin për mirëmbajtjen e rregullimit të rrjetit të ndriçimit publik në disa lokalitete në vlerën prej 117.000€ menaxheri i kontratës nuk ka bërë as renditet e pozicioneve të cilat e kanë dashur edhe as nuk i ka paraqitur e komuna i ka bërë pagesat. Pra që ky raport i auditimit e le komunën tonë pa grante, pa grante për shkak të performancës së dobët që e ka, keqmenaxhimit edhe keqpërdorimit të mjeteve që janë këtu.

Për shembull nëse ish kanë në rregull, ne si komunë kishim garuar për performancë komunale, i kishim fituar në 23 milion. Po për atë kur këtë diskutimi i buxhetit unë e kam thënë që ju keni bërë s'keni bërë projekte hiç edhe i keni çuar është i keni thënë 20.000€o 50.000€o Mere keni zotuar Preshinë një 60.000 70.000 rugën për ner që është projekti 3 milion ju i keni zotuar 2 milion i keni zotuar 50.000€ hero të njëjtë keni bërë për jezerc edhe që ky audit tim po çka është edhe më rëndësish me ja fal kryesues veç kështu për fund është mua po më vjen shumë interesant te arsimi për shembull prandaj auditori ju ka gjet tu punësuar njerëz edhe ja ka shkruar që as ata atë që keni punësuar në procedurat e rregullta ju s'i keni shti në listën e pagave me b me ngu kryetarin këtu thotë 17 milion i ka marrë për mbaruesi e që të me pas qartë qytetarët e Ferizajit që nuk është për shkak të kontratës kolektive por Është për shkak të këtyre keqmenaxhimeve të projekteve që ju i bëni në vazhdimësi edhe e keni të vetmen mundësi që doni të thoni është valla kontrata kolektive na ka marrë 17 milion i ka marrë. Kjo është veç gënjeshtër edhe për atë se për shembull Ferizaj ka buxhet të mjaftueshëm 56 milion euro hala duhet me të mjaftueshëm po është herë du rrit po që 56 milion euro për shembull ju jeni tu çuar krejt nëpër mbari as drita në qytet bre sot s'ka ja ka ndalë edhe krejt ja ka ndalë ndriçim se s'keni më kurrëgjë tash si e qet q tash buxhetin për shembull kur miratohen në shtator menjëherë për mbaruar se merr prapë keni

me u anku ama që ky raport nuk mshehet po unë nuk kam ja msheh kryetarit sa herë kam me ardhur këtu për çdo diskutim. Unë këtë raport kam me përdor.

Faleminderit shumë

Kryesuesi a ka të tjerë të interesuar për diskutim?
Urdhëro. Ejup Delolli.

Përsëritje kryetar. Të nderuar kolegë, ne si kuvendar jemi të obliguar ta trajtojmë raportin e auditorit me përgjegjësi dhe jo ta bëjmë politikë. Unë e kuptoj opozitën që dëshiron të jepë konotacion politik kësaj. Mirëpo ne duhet me kuptuar jo dhe ne këtu edhe qytetarët që janë katër lloje të kualifikimeve që i bën auditori. Më i keqi i mundshëm është muhim i opinionit. Ka opinion kundërshtues. Siç jemi ne aktualisht edhe është i pakualifikuar që do të ishte idealja. Ne nuk po mohojmë gjetjet. Po duhet marrë masa me i përmirësuar ato se unë mendoj që aty ku punohet edhe gabohet. Ka gjetje. Ma gjini ju mua një raport të auditorit në botë që nuk ka gjetje një jo në Ferizaj. në botë gjejmë një raport që s'ka gjetje. Çfarë vlere do të kishte auditimi nëse nuk do të ishte asnjë gjetje? Për çka do të ekzistonte raporti i auditimit? Duhet me pas gjetje se unë mendoj që po nuk duhet me paskelje ligjore.

Arsyeja është që këtu punohet. Janë disa aty që janë planifiku'. Nëse e lexoni me vëmendje. Edhe këta të Partisë të Lidhjes Demokratike e kanë të qartë bre se i kanë he raportet e auditorit të mëhershme të vetat. Prej vitit 2013 deri në vitin 2026. Raport më të mirë Kuvendi i Kosovës, Kuvendi i Ferizajit s'ka pas. Ësh me lexu bre. Merrni kqyrni e kqyr. Po kqy në rregull ë me ngu b se ti a di ne ju njo qysh jeni? Po duhet me ngu skëterr jeni ou 100%. Po për këtë s'ka dyshim. Unë mendoj që gjetjet duhet me i evidentuar edhe ne edhe duhet me i përmirësuar. Mirëpo me i dhënë konotacion politik edhe me mendu që e keni zbuluar ujë e nxehtë ju raportim nuk ka. Nuk gëzoni jo për projektet në 2025 u punu aty. Cilat janë projektet ato? Kurkush s' përmend ato që janë punu ato 2025 raporti është për 2025 nuk është për 2026. Asnjë s'i përmend projektet. A i shijojnë qytetarët ato edhe i shfrytëzojnë?

Veç logjika është hajde se këtu i kemi bërë disa gjetje edhe të kapemi këtu.
Faleminderit.

Kryesuesi Faleminderit.urdhëro Bashkim Haliti.

Përsëritje. Këtu po flitet sikur me qenë i njërës anë raporti i auditimit. Raporti i auditimit është prej agencionit kombëtar të auditimit që i ka kriteret e veta për auditim. Mandej ne as opozita nuk është e thënë me ekzagjeruar dhe s'është tu ekzagjeruar, është duke u bazuar në raport auditorit, mirëpo është e patolerueshme me u mundu me i mbuluar sendet që nuk mbulohen, nuk justifikohen. Ë kolega tha duhet me marrë me përgjegjësi edhe me u mundu me i evitu gjetjet. drejtoresha tha kemi bërë një plan të veprimit me i zbatuar rekomandimet prej raportit të kaluar të auditimit sa janë të përsëritura rekomandimet në këtë raport prej vitit paraprak kanë qenë 13 gjetje. 10 nuk kanë filluar me u zbatu hiç rekomandimet. Dy pjesërisht, një është zbatuar, janë që 13 në 2024n tash janë 19. Prej këtyre 19 dhe 10 janë të përsëritura gjetje të përsëritura që janë dhënë rekomandimet me me u zbatu ato rekomandime edhe s'janë s'janë zbatuar.

Tash ne s'mund me arsyetu sendet që s'arsyetohen.

Faleminderit.

Kryesuesi - Faleminderit. Dikush tjetër?

Urdhëro drejtor, Burim Bajrami.

Faleminderit shumë kryesues. Edhe ju kur e keni gjetur gjetjen edhe e keni lexuar gjetjen te Drejtoria e bujqësisë, me siguri keni qeshur në me vete a di që s ka paska dalë kjo gjete. Janë mbi 800 përfitues nga Drejtoria e Bujqësisë në vitin 2025 dhe në mesin e këtyre 800 përfituesve është gjetur një fermer që i punon 47 hektar tokës. 27 hektar janë të mbjellura me misër dhe 10ar me kulturën e grurit. Edhe na ka ardhur raporti preliminar i auditimit. Kena pasur kontakte të vazhdueshme me zyrtarët e auditimit. Jam takuar personalisht disa herë në momentin kur e kanë pruar raportin përdinor, unë e kam mbledhur komisionin që i ka vlerësuar aplikacionet. Edhe komisioni profesional ka thënë që në krahasim me aplikime të tjera ky fermer e meriton 100% me marrë një pajisje pllog dyrensh. Pavarësisht pse është arsyeuar që ka harruar me vendosur një nën kriter që është përcaktuar në thirrjen publike që ka qenë çertifikata e bashkësisë familjare.

Ka harruar me vendos aty edhe nuk ka dashur komisioni me i hy në hak përderisa është punëtori më më i madh gati në fshatin Greeme për mos me qenë përfitues në vitin e kaluar. E kemi sqaruar edhe për auditorin dhe ai nuk ka besuar në komisionin tonë. e ka marrë komisionin he ka dalë në terren me verifikuar nëse i njëjti fermer e ka pajisjen. Në mesin e verifikimeve edhe të fermerëve të tjerë ka shkruar edhe te i njëjti e ka parë pajisjen që është vë në funksion edhe është prezent në shtëpinë e të njëjtit fermer por prapë e ka qit si gjetje. Unë mendoj që ka pak më shumë se tendencë këtu me u prezantuar si si e gjeturde pavarësisht pse nuk ndikon në opinionin e e e e auditimit, po unë mendoj që është tendencë me shkru sa më shumë numra prej kujt nuk e di. Po sa më shumë numra, sa më shumë gjetje edhe të kësaj kësaj rëndësie të vogël qysh e ka ky dokument. i prezant. Faleminderit kryesues.

Kryesuesi Faleminderit drejtor. Dikush tjetër?

Arbër Bytyqi, urdhëro.

Faleminderit kryesues. Unë po jap një sqarim meqë drejtori i infrastrukturës nuk është këtu. Ë ka të bëjë me njoftimin publik që është bërë për kontrata. Ë arsyeja pse ka ndodhur kjo dhe pse është gjetje në raportin e auditorit është për shkak që memorandumet të nënshkruhen para se të bëhet plani i prokurimit. Plani i prokurimit, plani i prokurimit bëhet në fund të vitit, ndërsa memorandumet bëhet gjatë vitit. Domethënë memorandumet bëhen e bashkëpunimit me ministri pas publikimit të planit të prokurimit dhe këto gjetje na mbesin në planin e prokurimit. Ndërsa sa i përket disa rrugëve në fshatin Zllatar, me informata që i mora nga drejtori, janë rrugë që janë në kuadër të memorandumit të bashkëpunimit me ministrinë dhe Ministria e Infrastrukturës ka qenë e informuar për të gjitha këto rrugë që janë asfaltuar.

Faleminderit.

Kryesuesi Faleminderit. Drejtore e keni fjalën. Sebahate Ajeti.

Faleminderit kryesues. Atëherë sa për sqarimë raporti i auditimit për pasqyrat financiare për vitin 2025 për komunën e Ferizajit dëshmon qartë se pasqyrat janë përgatitur dhe janë paraqitur në mënyrë të drejtë duke ofruar pasqyrim të besueshëm të gjendjes financiare. Nga 19 gjetje të evidentuara janë gjithsej tetë gjetje të reja. një është pjesërisht e përsëritur dhe 10 janë gjetje të përsëritura. Fatmirësisht dhe çka na gëzon fakti që për dallim prej të tjerëve këto gjetje nuk përbëjnë gjetje penale apo keqpërdorime financiare janë kryesisht çështje administrative dhe procedurale e për të cilat kërkohet dhe janë dhënë rekomandime dhe afate të caktuara për

përbushjen e tyre. Shumica e gjetjeve lidhen pra me drejtoritë përkatëse ku edhe janë përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve. Në planin e veprimit siç e potencova në fillim edhe i kemi dërguar komentet dhe afatet për përbushje të këtyre gjetjeve e të cilat do duhet që t'i adresojmë. Ne në muajin shtator përsëri do ta sjellim po këtë raport auditimit me planin periodik të zbatimit të këtyre gjetjeve, por që nuk është asnjë gjetje penale apo keqpërdorim i detyrës siç u potencua nga disa asamblesë të opozitës.

Duhet ta dini që për çdo gjetje rekomandimet e auditorëve dhe arsyetimet jepen në po në fund të atyre gjetjeve. Po nga disa u pa që vetëm shablon kanë bërë shkrimet e tyre dhe është lehtë për të dalur e për t'i lexuar dhe për ta lajthitur opinionin publik. Ë vlen të theksohet se edhe njoftimet paraprake në drejtori të në zyrat të prokurimit faktikisht nuk janë procedura të cilat janë lidhur me negociatë. Nuk jemi ne prej atyre që i thërrasim kompanitë dhe ju themi ejani se po ju japim 60 milion për gjashtë muaj. Të gjitha procedurat janë publike. Të gjithë operatorët ekonomik kanë pasur të drejtë të aplikojnë. Këto gjashtë projekte po ashtu janë financuar nga ministria dhe normalisht paraprakisht edhe drejtoria përkatëse e cila ka bërë iniciimin e këtyre procedurave, por edhe zyra e prokurimit kanë pasur një konfirmim nga Ministritë e Lindjes për të vazhduar me lidhjet e këtyre kontratave. Sido që të jetë raporti i auditimit të komunës së Ferizaj për vitin 2025, lirisht mund të themi që është njëri nga raportet më të mira që ka pasur komuna ndonjëherë, edhe pse me 19 gjetje, përsëri nuk janë gjetje të natyrës penale, por që janë gjetje të natyrës procedurale dhe administrative e për të cilat ne jemi zotuar që deri në fund të vitit 2025 do t'2026 do t'i përbushim të gjitha. Keni me marrë raportin periodik të zbatimit të këtyre gjetjeve çdo gjashtë muaj po në këtë kuvend dhe nuk kemi asgjë për të fshehur apo për t'i ikur përgjegjësisë, por që do të ishte mirë që opinionin publik të informohet sakt edhe e drejtë e mos të përdoret këtu foltorja e kuvendit vetëm për disa po politike. Faleminderit.

Faleminderit drejtoreshë. A ka tjerë të ndjë për diskutim? 100 herë s'ka kuptim. Do i doli tre herë. Nuk përmend emra.

Raporti financiar për periudhën janar-qershor 2026.

Drejtoresha dëshirë marrë fjalën.

Faleminderit kryesues.

Sa i përket raportit të hyrave financiare dhe shpenzimit të buxhetit për periudhën janar-qershor të vitit 2026 nga raporti i të hyrave vetanake që kemi gjithsej planifikim prej 7.660.269€ gjatë periudhës janar-qershor komuna e ferizaj gjithsej ka realizuar vlerën prej 3.103.299€59 cent prej të cilave 2.165.595,95 cent janë të hyra vetanake nga programet e komunës. Ndërkaq 937.703,64 cent janë të hyra indirekte nga gjobat e trafikut, gjykatës dhe të AKP-së. Realizimi i përgjithshëm i planit të hyrave vetanake për vitin 2026 është gjithsej prej 40.51% realizim të planit. Ndërkaq krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025 kemi një rënie prej 54.02% për shkak se ndikimin kryesor nga këto të hyra i kemi pasur nga të hyrat e drejtorisë së urbanizmit si dhe nga tatimi në pronë. Këtë gjashtë mujor të hyra nga urbanizmi kemi pasur më pak sesa periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Ndërkaq tatimi në pronë e dimë të gjithë që fatura e tatimit në pronë, vonesa dhe telashet që na ka shkaktuar ministria me sistemin e tatimit në pronë kanë ndikuar që qytetarët të mos mund t'i paguajnë obligimet e tyre me kohë dhe shtyerja e afatit të faturave, realisht e shpërndarjes së faturave ka ndikuar që mos të kemi një realizim të ballshëm dhe të kënaqshëm. Sa i përket shpenzimeve të buxhetit, tanimë e dimë të gjithë dhe është lajm i hapur siç e din dhe opozita, që shpenzimi i buxhetit për këtë vit na ka ndikuar një pjesë prej kontratës kolektive, një pjesë prej obligimeve dhe mund të konsiderojmë që mbi 70% është shpenzuar deri në këto momente kur edhe flasim për të gjitha kategoritë ekonomike, përjashtuar kategorinë e pagave.

Faleminderit. Jam këtu. I keni marrë raportin, i keni edhe tabelat nëse doni ndonjë sqarim shtesë. Faleminderit.

Kryesuesi Faleminderit drejtoreshë.

A ka të interesuar për diskutim rreth?

Shkurte Krasniqi Neziri

Faleminderit kryesues. Përshëndetje të gjithëve. Atëherë në raportin financiar të paraqitur po shihet një rën alarmante hyra vetenake në krahasim me vitin 2025. Vetë raporti e pranon rrezikun fiskal ku një pjesë e vogël është realizuar i tyre vetë dhe një ritëm shumë i madh i shpenzimeve të mbet. Çfarë do të ndodhë gjatë pjesës tjetër të mbetur të vitit kur kaq shumë shpenzime kemi? Prandaj kam disa pyetje që janë në interes për qytetarët. Pse të hyrat kanë rënë në 54.02% 02% në krahasim me vitin 2025 veç e kush mban përgjegjësiat nga lejat e ndërtimit kanë rënë në 86.75% dhe çfarë masa konkrete po merr komuna për të rritur të hyrat vetanake dhe për të ulur varësinë nga grandit qeveritar edhe në fund si do të mbulohen nevoja deri në fund të vitit ku shpenzimet janë rritur kaq shumë. Faleminderit.

Kryesuesi Faleminderit. Dikush tjetër a dëshiron të diskutoj? Si duket nuk ka. Urdhëro Ejup Delolli.

Faleminderit. Drejtoresha u dashur me potencu edhe që të hyrat vetanake, mungesa e të hyrave vetanake për këtë vit është si pasojë e vendimeve të Ministrisë të fakturave të tatimit në pronë. që nuk kanë ardhur me kohë dhe normalisht që është problem inkasimi i tyre. Faleminderit.

Kryesuesi Faleminderit Ejup. Dikush tjetër drejtoreshë Sebahate urdhëro.

E potencova edhe në fillim të raportit që të hyra nga drejtoria e urbanizmit vitin e kaluar kemi pasur më tepër sesa gjatë kësaj periudhe kur edhe kur po e diskutojmë raportin për shkak se drejtoria ka marrë masa që me i ngasuar të gjitha obligimet të cilat i kanë palët. e treta ndaj komunës. Po ashtu edhe te tatimi në pronë veçse i kemi shpërndarë letër kujtesat e para të tatimpaguesit. Domethënë kemi shkuar me radhë nga tatimpaguesit që kanë borxhe më të larta. jemi duke vazhduar që deri në borxhinë e fundit në një farë mënyre ose deri në mbi 300€o të gjithë ata tatim pagues që i kanë obligim komunës për tatimin në pronë do duhej që të lajmëroheshin dhe të paguanin deri tani në mënyrë që ne mos detyrohemi t'i ngasojmë obligimet e tatimit në prë përmes përmbarimeve siç po veprojnë palët e treta ndaj komunës. Ndërkaq te shpenzimet e larta se çfarë do të ndodhë me komunën, tanë e dimë që investimet kapitale veç janë ekzekutuar në fillim të aprovimit të buxhetit. Domethënë në muajin mars janë inkasuar mbi 10 milion euro dhe si rezultat i kësaj komuna nuk ka mundur të vazhdojë tutje që të lidhë kontrata të reja ose të punojë me kontrata të cilat janë të lidhura. jemi duke afaruar vetëm ato projekte për të cilat operatorët kanë kontrata aktive dhe për të cilat pritet përfundimi i projekteve, por që pagat jemi detyruar të i shtyjme për vitet e ardhshme. Ju e dini që edhe kur nize afatmesme buxhetore kur i kemi aprovuar në muajin qershor nuk kemi pasur mundësi të kemi projekte të reja pikërisht se është dashur të planifikohen shlyerje të obligimeve të këtij viti për vitin e ardhshëm kështu që shpenzimet e buxhetit për të gjitha kategoritë pothuajse janë në përfundim e sipër do të afarohet vetëm me kategorinë e listës së pagave që dhe i kemi obligim ndaj poan njerëzve të administratës komunale. Faleminderit.

Kryesuesi Pika 6 – Propozim-vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm të ngastrave kadastrale 678-1 dhe 678-2, zona kadastrale Talinocv.
Fjalën e merr drejtoresha e kadastrit Festina Sadiku, e cila pasi përshëndet të pranishmit thekson.

Kjo edhe pika tetë janë për të njëjtin qëllim. Propozimet lidhen me një projekt shumë të rëndësishëm për komunën e Ferizaj, projektin për banimin social dhe të përballueshëm. Ky projekt mbështetet prej një grandi të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Për realizimin e këtij projekti është e nevojshme të sigurohet parcela nga komuna. Dua të theksoj se parcelat e propozuara nuk janë të regjistruara në emër të komunës Ferizaj, mirëpo janë në administrimin e agjensisë agjensisë kosovare të privatizimit. Pas disa takimeve me grupin punues që është caktuar nga ministria, kemi diskutuar për përzgjedhjen e këtyre parcelave në bazë të kriterëve të projektit. Parcelat siç i ceku edhe kryesuesi janë 678/1 dhe 678/2 në talinoc të jerlive me sipërfaqe 57ari e 65 m ndërsa në pikën tetë parcela është 100-1 zona kadastrale Ferizaj për me sipërfaqe 43 ari e 39 metra.

Kryesuesi faleminderit drejtoreshë a dëshiron dikush të diskutojë? Si duket nuk ka atëhereë kush është pra që të kalojë propozim vendimi për shpalljen e interesit të përgjithshëm të ngasës kadastrale 678-1 678-2 zona kadastrale talinoc I jerlivekush është për lutem numëroj. 28për kundër 0, abstenim 7.

Kryesuesi vazhdojmë me rendin e ditës. Kryesuesi e lexon pikën e 7 të rendit të ditës dhe ia kalon fjalën drejtoreshës së kadastrit Festina Sadiku.

Ka qenë kërkesë mu paraqit me projektor. Qysh e keni lyp keni me gjet. Ani na e vazhdojmë. Kur të ka nevojë, kur të ka nevojë. Ju të lutem.

Atëherë për këtë pikë e propozojmë vendimin për këmbimin e pjesëve të parcelës 320-0, 321/2 dhe 308/6 në Talinocvë të jervime me pronë private me pjesën e parcelës 459-1, zona kadastrale e Talinov i jerlive që është pronë e komunës së Ferizaj. Fillimisht këto prona private janë shpronësuar me vendimin e shpronësimit me në bazë të këtij vendimi pastaj kanë shkuar në vlerësimin e pronave në Ministrinë e Financave kanë qenë dy vlerësime. Vlerësimi i parë qysh po e shihni edhe në dokumente ka qenë 96 euro për met katror pastaj ka qenë 300€ për meter katror. Mirëpo duke marrë parasysh që jemi në mungesë të mjeteve financiare pala ka kërkuar që me u tërheq prej pjesës së shpronësimit dhe me vazhduar me kërkesën e këmbimit.

Të bashkangjitur e keni edhe vendimin përfundimtar të shpronësimit, certifikatat e pronësisë, raportin e vlerësimit të pronave për dy vlerësime dhe në fund e keni skicën, po tash po ja shpjegoj edhe këtu në e kemi gjoportal edhe në pjesën e autokadit. Arsyeja që e paraqes edhe në Gjobortal është që kjo ortofoto në këtë autokad është i vitit 2018 dhe janë disa ndryshimeve në vitin 2024. Domethënë kjo qysh po e shihni nuk është gjendja aktuale në terren parcela 308 për gjashtë domethënë çim verdha është për shkak të projektit për zgjerrimin e rrugës së Driton Islami q kjo pjesa e 64 m është marrë pronarit ndërsa kjo me të kuqe vija me të kuqe domethënë jemi duke ja jap pjesë së këmbimit gjithashtu edhe për parcelën 320 domethënë kjo me gjalbër qysh po e shihni është 320shi. Me të verdhë është pjesa e këmbimit 13 m, ndërsa pjesa tjetër me të kuqe është 33 m. Edhe kjo pjesa tjetër e verdhë është pjesë që e kemi marrë nga rruga që është pronë komunale për pronën private 321 për2 dhe jepet pjesën e këmbimit 33 m kjo pjesa më të

kuqe ndërsa aktuale është kjo gjendja ortofotoj 2024s do të thotë kemi të bëjmë me këtë parcelë edhe me këtë dy parcela të tjera Faleminderit. Keni këtu të cekun 2017.

Kryesuesi e qet në votim këtë pikë dhe kalon me 23 vota për, 0 kundër dhe 7 abstenime.

Pika 8 – Propozim-vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm të ngasës kadastrale 100-1, zona kadastrale Ferizaj.

Kryesuesi propozim vendim për shpalljen interesit të përgjithshëm të ngasës kadastrale 100-1 zona kadastrale Ferizaj Kjo që e sqaroi drejtoresha që është e njëjtë me pikën e gjashtë. Megjithatë a ka nevojë me janë për qëllimin e njëjtës. Po. A dëshiron dikush të diskutojë kush është që të kalojë propozim vendimi për shpalljen e interesit të përgjithshëm të ngasës kadastrale 100-1 zona kadastrale Ferizaj. Kush është për Me 25 vota për, pro kalon, 0 kundër, 7 abstneim.

Pika 9 – Propozim-vendim për aprovimin e Rregullores për taksat komunale.

Sebahate Ajeti Faleminderit kryesues. Sa i përket rregullës për taksa komunale, e kemi bërë ndryshimet dhe kemi përshtatur pikat e kësaj rregullore me ligjet dhe aktet aktuale në fuqi, disa udhëzime administrative nëpër Ministritë e Lindjes dhe për të cilat është paraqitur nevoja për ndryshim plotësimin e kësaj rregullore. Kjo rregullore i ka kaluar të gjitha hapat e diskutimit publik dhe si të tillë kërkojmë aprovimin final nga Kuvendi i komunës, por që e kemi një kërkesë kryesues që momentin e aprovimit të kësaj rregullore të aprovohet vetëm deri në nenin 50. Këto dispozitat kalimtare dhe përfundimtare fatkeqësisht i kanë ikur stafit në përgatitje e sipër dhe nuk janë rifreskuar, por që janë vetëm çmimore në mënyrë tabelare nga rregullorja e vjetër. Kështu që të gjitha çmimore të cilat janë aktuale dhe të përshtatura me ligjet në fuqi i keni deri te neni 50 dhe si të tillë kërkojmë që të aprovohet pa kapitullin numër tre. Te dispozitat kalimtare dhe përfundimtare dhe ashtu nuk janë të nevojshme që të jenë pjesë e kësaj rregulloreje. Faleminderit.

Shkurte Neziri pasi përshëndet të pranishmit thekson që:

Unë kam kërkuar tek neni 46 pika 1.7 që të bëhet ndryshimi ulja e tarifës prej 35€ një fëmijë dy prindër të papunë kur ka qenë projekt propozim 46 pika 1.7 Shtatë po flas në emër të prindërve. Nuk ju mohet e drejta e shkollimit të hershëm fëmijëve që s'ka prindër të papun. Faleminderit.

Sebahate Ajeti Më falni veç pak të dy prindërit pa punë në momentin që dërgojnë fëmijën në kopsht paguajnë 35€ Nuk është fjala për s'kanë më nevojë me çu ata pa punë se janë. Jo jo veç pak [të qeshura] realisht s'ka logji kjo punë ata me fet me çu fëmijë në ks kryesues nëse më lejohet një sqarim ju lutem ju lutem ë e dimë që në çerdhet publike domethënë te ardhmëria jonë edhe te engjut që e financon komunë kushti kryesor për me dërgu fëmijë në qerdhe ka qenë me qenë të dy prindërit në punë moment deri tash momentin që njëri prind ka qenë pa punë. Normalisht që përparësi kanë pasur ata fëmijë të cilët dy prindërit i kanë pasur në punë. Në diskutim e sipër me drejtorin, e dimë që tash ligjërish edhe është bërë që prej tre prej moshës tre vjeçare obligim ligjor është që të dërgohen fëmijët në kopshte t'i frekujnë kusht kopshte domosdo. Po për këtë ende nuk e kemi zbatuar edhe është tjetra që qeveria duhet me marrë masa qysh edhe e ka ndryshuar ligjin. A po dëgjoni opozita e Vetëvendosjes që me i marrë masat brahim mundesh me na ndihmu në këtë rast te Ministria e Arsimit sepse e ka ndryshuar legjislacionin edhe prej tre vjetëve është bërë obligative që fëmijët t'i frekuentojnë kopshtet

mirëpo ne edhe kemi mungesë të kopshteve publike edhe nuk mundemi me i institucionalizuar për shkak se qeveria nuk na ndon mjete për të rritur stafin e stafin arsimor për kopshte për arsimin parashkollor. Ne e kemi, ne e kemi qarkorën buxhetore edhe për vitin 2027, në të cilin i kemi pas deri tash domethënë 12 vende, nëse s'gaboje drejtor, më plotëson të lutem që janë plotësuar po prapë nuk mjaftojmë se tashti nëse marrim statistikën e fëmijëve tre vjet e tutje, domethënë deri tre deri në gjashtë, normalisht se një çerhe apo dy apo tre nuk mjaftojnë. Qeveria e dimë që ka pas premtim goxha do që edhe me i ndërto, po s'ka marrë masa në këtë aspekt ende asnjë hap.

Fatbardha Reka

Përsëritet kryesues. Përsëritet kolegë të nderuar qytetarë. Është në rastin që u përmendte çështja e çerdheve e që gjithmonë po thirrreni në qeverinë se nuk ka investuar në ndërtimin e çerdheve, unë e di një deklaram të drejtorit të arsimit që thotë nuk kemi tokë për me ndërto çerdhe. Kjo ka qenë e vetmja kërkesë e ministrisë për me investuar në çerdhet e Ferizajit. Gjithashtu kur thirrreni në numrin e edukatorëve apo të stafit për çerdhet, nuk e di sa jeni duke e zbatuar ligjin ku edukatorët e qytetit tonë nuk mbajnë orë pune aq sa është e përcaktuar me ligj. Domethënë për një orë e gjys ato paguhen për normë të plotë. Për një orë e gjys pune paguhen për normë të plotë 40 orëshe në javë. Kështu që me zbatimin e ligjit ju mund t'i hapni edhe shumë e shumë dyfishin e çerdheve që i keni dhe sigurisht do ta lehtësojmë ë do ta lehtësojmë gjendjen e qytetarëve sidomos në edukimin parafillor. Edukimi i hershëm është nevojë imediate e qytetërimit. Kështu që mos e zini në përgojë ministrinë duke e akuzuar për këtë çështje. Po bazohuni dhe lavdoheni qeverinë për masat që i ka marrë në këtë aspekt. Është shumë e rëndësishme ta keni parasysh çka ka bërë komuna në këtë aspekt. Është shumë e rëndësishme ta kuptoni që keni ndë dhoma mësimi të parafillorëve në dy pjesë me nga 10 nxënës për me punësu edukatore të tjera që në fakt një edukatore duhet t'i ketë së paku dy grupe. Së paku dy grupe. E në Ferizaj ky ligj nuk zbatohet. Do të thotë zbatoheni ligjin, përcaktoni tokat, parcelat ku duhet të ndërtohen çerdhet edhe mos e merrni qeverinë nëpër gojë.

Faleminderit. Ju lutem.

Urdhëro drejtor.

Urdhëro drejtor.

Faleminderit kryesues. Afrim Llabjani Përsëritet për të gjithë. Është e vërtetë ajo që është ngritur, ngrit këtu, por kur kam deklaruar unë, kam deklaruar se ministria ka kërkuar tokë në vendet urbane për ndërtimin e çerdheve dhe ne kemi thënë që nuk jemi aty ku e kemi pas jemi duke e ndërto. Ju e dini që erdhën në rrugën Rexhep Islimi që është e nënshkruar nga një qeveri paraprake, por që punimet kanë vazhduar he vazhdojnë edhe sot e tutje. Çerdhja tjetër është në fshatin Dardani që është e ndërtuar prej Ministrisë së Arsimit edhe e kemi një adaptim të një çerdhe në fshatin Babush. E nderuar, e përmende stafin shtesë, stafin e edukatorëve. Është një temë e cila nuk është diskutuar akoma as në Republikë të Kosovës, ashtu siç e kërkon trajtimin, por nuk kemi thënë asnjëherë që ka mungesë të edukatëve. Ne kemi thënë që ka mungesë të stafit të shtesë lidhur me funksionalizimin e çerdheve. Ne jemi detyruar me i lidhur marrëveshjet me kalitas edhe me i funksionalizuar dy çerdhe të cilat tanië edhe janë funksionale. Është fjala për kopshtin e që ka nga viti 2012 edhe fshat në fshatin në fshatin Greme. Krejt atë pjesë të cilën e kemi pasur të lejuar nga Ministria e Arsimit për të punësuar edukatore ne i kemi kryer procedurat dhe jemi në përfundim të përfundimit të kryerjes së këtyre procedurave për të marr staf. Por kini parasysh stafi ka të bëjë vetëm me edukatore, ndërsa çerja nuk mund të funksionalizohet vetëm me edukatore sepse aty vijnë staf shtesë që është i profesioneve të ndryshme. Prandaj kjo ka qenë pengesa. Ndërsa pjesa tjetër të cilat ne i kemi ë përcjellë në ministri lidhur me ndërtimin e

çerdheve janë edhe fshatrat të cilat tani jemi në proces për t'i përcjellur parcelat në mënyrë që të i ndërtojmë. Kjo çështje është ngritur edhe në Ministrinë e Arsimit që të punohet në drejtimin e punësimit të stafit të shtesë, jo vetëm të edukatorëve, sepse forma për të gjetur edukatore dhe për të punësuar besoj se janë disa nga ato që që edhe u përmendën. Faleminderit.

Kryesuesi Urdhëro Brahim Osmani Faleminderit kryesues. Për besë e drejtëm nuk jam i interesuar me të ndihmu ty. A e din? Unë jam i interesuar me ju ndihmu qytetarëve. E para, e para për sa i përket e dyta që është ju e dini prej vitit 2021 kryetari Agim Aliu e ka hequ prej kodit buxhetor të çerdhën e Talinove Muhaxherve.

Kryetari e ka heq krejt edhe nuk është e vërtetë që s'ke prona drejtor Talinove i Muhaxherve. Është e pavërtetë a ok për në atë pjesë a s'ke çuar projekt për asnjë t'çer d nuk keni çuar projekt edhe në komogllavë edhe në grykën e neredimës asnjëri ju seni të interesuar vetë me i pa sa i përket rrugën Rexhep Bisnimi është çell e financuar prej qeverisë në Babush është bërë prej qeverisë në

Dardani ka me bë prej qeverisë bëni projektet dorëzoni ju që ju ndihmojmë juve se s'jeni të interesuar me ju ndihmu juve juve jeni interesuar me ju larguar juve po me ju ndihmu qytetarëve që të me vërtetu kë qysh po vërtetohet në nivel qëndorr edhe në nivel ferizaj.

Shkurte Neziri Krasniqi Faleminderit shumë përderisa nuk nuk kena qerdhe obligative prej vjeteve nëpër fshat, atëherë besoj që neni 1.7, 1.8, 1.9 duhet të heqen të gjitha nga taksat komunale.

Faleminderit.

Faleminderit. Urdhëro Sadat Ismajli. Ë përshëndetje për të gjithë. Ja pra meu. Ju lutem mos se për fshatin Komogllav sa i përket çerdhës e kemi pas në kod buxhetor të komunës. E ka marrë përsipër ministria. Ne e kemi heq atë kod. Mirëpo kanë ardhur dhe kanë dashur me ndërto ata ku kanë dashur. Jemi mbledhur. Unë jam që n takime rregullisht. ka qenë edhe deputeti Valoni, ka qenë edhe Ekrem Mustafa në atë kohë kemi biseduar. Po ku kemi dashur ne me ndërto ju s'keni dashur, ju keni dashur shkollën e vjetër me adoptuashë objek. Edhe e para, e dyta, ne kemi dash dëshira e komogllavasve ka qenë me ndose në gërllicë që me i përfshi Rakajt, Varoshiin, Komogllavën ose kemi dashur ndalje te autostrada, e kemi pas parcellën, kemi dashur me ndërto aty. Po ju s'keni dashur. Ju ishin në zgjedhur hajde ta bëjmë kështu si shpejt nuk bëhen qerdhe shpejt. A duhet me b ngadale? Edhe ku është interesi i qytetarëve? Jo që ne s'kena dashur me bë çerdhe, po ju s'e keni bëë çerdhen. Dhe tash e kemi shti prapë ë në buxhet të komunës nga pak nga pak jemi i mbledhur me fort edhe e bëjmë diqysh veç veç hajde prem dash k veç po e diskutoj kryesues një zgjedhjet Brahim Osmani sikur kjo punë dëshir ku k dash Ç ka bë që veç nja pes zgjedhjet besoj që për një vjet ja mbajt dy herë të r secilën herë që kena dalë në komogllav ti e din 60% kena mujt's kena pas për zgjedhje ne as e kena sot. A po kupton? Po projektet ti e din për shembull q veç një minut veç një minut projektin. A e keni dorëzuar në ministri?

Po di fol. Po e ke dëzuar? [të qeshura] Faleminderit shumë.

Faleminderit.

A ka të tjerë të interesuar për diskutim? Drejtori Afrim Llabjani, faleminderit kryesues Brahim. Vetëm e pohove atë që e thashë edhe unë komplet pothuajse e para. E dyta, asnjë kod buxhetor ne nuk e kena he për çerdhe. Arsyet pse janë kanë qënë bashkëpunimet me ministri, sepse ministria ka kërkuar nga ne që janë të interesuar për me investu në edukimin e fëmisë së hershme dhe e kemi shfrytëzuar këtë pjesë për shkak se e tha edhe vetë ne jemi këtu për me i ndihmu

qytetarëve. Edhe kjo ka qenë absolutisht asnjë qer. Çerdha në fshatin Redime, në fshatin Talenovcë janë kod buxhetor. Tashti i ke edhe në projekt buxhet i ke. Po arsyeja ka qenë te shpronësimi i pronave që ne e kemi bërë edhe atë në fshatin Redime dhe tash jemi në proces për t'i përcjellur projektet në mënyrë që të fillojmë investimin. Problemin e kam me staf jo me ndërtim të qedhjeve sepse ne e kemi edhe një çellë në babush e cila po shprehen popullor që dhe lugët janë aty.

Por nuk po mundemi me funksionalizu për shkak të mungesës së stafit. Jo për shkak të mungesës së edukatoreve, po për shkak të mungesës së stafit të shtesë, i cili na duhet për ta funksionalizuar qeverin. Sepse ne dimë tash me ligjin e ri që është obligative fëmëria, edukimi fëmijërinë e hershme. Edhe një çështje se u përmend këtu një ndarje e dhomave në shkollë. Po po besoj që e din fort mirë fatbardha që kjo ndarje e kësaj dhome është bërë jo në pushtetin të cilin jemi ne, po pak para sa me ardhë na. Faleminderit.

Faleminderit. Është mirë me me sheru drejt.

Pra e kemi propozim vendim për aprovimin e rregullores për taksat komunale. Unë e qes në votim të aprovohet pra pa kapitullin numër tre. Kush është për? Ju lutem api numron: 22 vota për, 14 kundër abstenim s'patë s'ka.

Po, vazhdojmë me pikën numër 10, propozim vendim për miratimin e plotësim të ndryshimit të strategjisë për zhvillimin dhe fuqizimin e rinisë në komunën e Ferizajit 2024-2029 dhe planit të veprimit 2024-2027.

Kush është prej drejtarëve këtu që e sqaron?

A dëshiron dikush të diskutojë? A që kemi dashurinë e kemi udhëheqen e dashuri rinisë.

Dashuriije Ahmeti

Ë i nderuar kryesues, të nderuar ë ju lutem për qetësi asambleista, shumë të respektuar drejtor, në mungesë të drejtorit të kulturës, rinisë së sportit për shkak të pushimeve edhe axhendave të tjera. Sot jam ardhur për për ta mbrojtur ose për të dhënë shpjegime shtesë sa i përket pikës së 10 të rendit të ditës që ka të bëjë me plotësim ndryshimin e strategjisë dhe planit të veprimit për rini. Ka shumë rëndësi që jeni komuna e parë në Republikën e Kosovës. Kërkoj falje pak nëse zoni po më vjen kështu se është hera e dytë gjatë rrugëtimit tim institucional që mbroj procese ose dokumenta që lidhen me fushën e rinisë. në fakt e përfaqësoj drejtorin, kështu që keni pasur mundësi që me pa që jemi komuna e parë në Republikën e Kosovës që po vendosim dy parimet bazë të OKB-së për ë nivelin lokal dhe ju këto dy axhenta keni mundur edhe me i lexu që ka të bëjë pasja, siguria dhe rinia dhe axhenda tjetër ka të bëjë me gratë, pasqja dhe siguria. Nëse keni arritur me e shfletuar ë komplet dokumentacionin, këto dy axhenda i kanë pesë parime bazë. Domethënë pesë parime bazë për të cilat OKB-ja i obligon jo vetëm shtetet e Evropës për të cilët punojnë në procese rinore por edhe Ballkanin Perëndimor. Sa për informacionin tuaj, tre vjet e fundit jemi komuna që udhëheqemi në në kësi procese dhe unë po i ndaj ë edhe po e ndaj me juve ku është bazuar e gjithë kjo axjendë domethënë në rezolutën 2250 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuar. Barimet bazë të këtyre dy axhendave në theks të veçantë rinia, paqja dhe siguria kanë të bëjmë me pjesëmarrjen, mbrojtjen, parandalimin, partneritetin dhe rintegrimin. Krejt këto procese janë procese institucionale që komuna jonë është zotuar në konferencën e vitit të kaluar që do të jetë e para që do t'i vendos në nivel të dokumentave ë domethënë edhe së strategjive. Nuk kemi ndryshuar kurrjë prej strategjisë për të cilën ju e keni aprovuar dy vjet më herët, por vetëm i kemi vendos këtu dy axhenda që neve si drejtorja e kulturës rinisë sportive në partneritet të ngushtë me drejtorinë e arsimit sepse të rinjtë janë pjesë e procesit arsim e proceseve të ë zhvillimit arsimor atëherë edhe të drejtorisë së zhvillimit ekonomik janë nja tre drejtori që atakohen direkt prej këtyre dy axhendave. Natyrisht institucion

ë ose partneritet i përhershëm i zbatimit të këty dy të dy axhendave do të jetë edhe policia e Kosovës, sepse kemi të bëjmë me sigurinë e të rinjve, rintegrim dhe mbrojtjen prej konflikteve. Unë kaq e pata si shpjegim fillestar. Nëse keni pyetje edhe doni detaje më të tjera, natyrisht ne do të jemi të hapur. Kisha kërkuar me i votuar sepse kjo praktikë që e sjell Drejtoria e Kulturës Rinisë, sportit në fakt sektori i të rinjve është praktika e parë në nivel vendi dhe do të jemi model për shtetet e Ballkanit Perëndimor për të parë se a jemi të zot për t'i zbatuar këto dy axhenda dhe a jemi të zot që në proceset rinore evropiane të dalimi dhe të rekomandojmë se cilat janë hapat dhe masat që kemi marrë në zbatim të këtyre dy axhendave. Faleminderit shumë.

Pika 10 – Propozim-vendim për miratimin e plotësim-ndryshimit të Strategjisë për zhvillimin dhe fuqizimin e rinisë në Komunën e Ferizajt 2024–2029 dhe planit të veprimit.

propozim vendim për miratim, plotësim, ndryshimin e strategjisë për zhvillimin dhe fuqizimin e rinisë në komunën e Ferizajt 2024-2029 dhe planin e veprimit 2024-2027. Kush është për 33 vota, 00.

Vazhdojmë me pikën e rendit të ditës numër 11, propozim vendim për bashkëpunim me GLV bifurkacionin.

Urdhëro të drejtor Burim Bajrami Faleminderit shumë kryesues. Ë, grupi lokal i veprimit bivorkacioni përbëhet prej profesionistëve të sektorit të bujqësisë të komunës së Ferizaj dhe ekziston nëpër disa komuna si grup lokal i veprimit aplikojnë në Ministri të Bujqësisë për të përfituar projekte të vogla dhe për t'i implementuar në terren. Në këtë rast ë në Ministri të Bujqësisë kanë aplikuar për dy projekte siç është rrethimi i hapësirave të varreza në fshatin Nerodime Ult dhe një urë përockën e fshatit Softaj. Ë është e obligueshme prej tyre që të kenë marrëveshje bashkëpunimi me komunat, në këtë rast me komunën e Ferizaj dhe unë kërkoj nga ju që ta aprovojme këtë marrëveshje të bashkëfinancimit bashkë me grupin lokal të veprimit. Faleminderit po janë mjetet, janë mjetet për implementim.

Urdhëro Amir Rexhepi.

Faleminderit. Veç një pyetje po më intereson se komuna po tash kemi participuar me 2.000€ a keni ku i merrni këto 2.000€oa jo? Se du e marrë parasysh gjendjen financiare që është komuna e Ferizajë.

hala pa ma bë pyetjen tu përgjigja që i k i kema mirëp Faleminderit.

A ka të tjerë të interesuar për diskutim?

Si duket nuk ka. A jeni pra që të kaloj propozim mendimi për bashkëfinancim me GLV bifurkacion?

Kush është për 33 vota për a ka kundër? 0, abstenim 0.

Vazhdojmë me pikën e rendit të ditës numër 12, propozim vendim për ngritjen e tarifave, ndryshimin e rregullores 01 numër 124 për parkingjet publike në komunën e Ferizajit.

Urdhë drejtor.

Alberton Sahti

Faleminderit kryesues. Sa i përket punës të rritjeve tarifa dhe çmimeve besoj që jeni në rregull se jeni mësuar kohën e fundit me na rrit çmimet e jetës se nuk mendoj që me diskutu goxha shumë këtë pikë. Faleminderit kryesues. Po tash ke të drejtë para se nuk është ndonjë farë teme tepër e madhe kështu nuk e bëra sju vrajta Brah.

Faleminderit i nderuar kryesues të nderuar ëh asamblista a po do me ja nis menjëherë.

Të nderuar asambleista, të nderuar drejtor, ë me lejoni që para jush të paraqes një kërkesë të kompanisë NPL ambienti që është drejtuar komunës së Ferizajit juve si kuvend për rritjen e tarifa e parkinsve publike që menaxhohen nga kjo nga kjo kompani. Bëhet fjalë për një rritje të arsyeshme besoj të të përballueshme për shfrytëzuesit e parking apo qytetarët e shtytit tonë. Pa bërë krahasime të detajuar me operatorët privatë që operojnë në komunën e Ferizajit, mund të themi se edhe pas miratimit të këtij propozimi tarifat e parkingve publike do të mbeten më të favorshme për qytetarët e komunës sonë. Siç jeni dijeni, njëri ndër gërpimet kryesore të financimit të kompanisë Ambienti janë të hyrat nga ngasimi i parkingjeve publike. Rritja e tyre tarifa do t'i mundësojë kompanisë një stabilitet më të mirë financiar, përmirësim të shërbimeve për qytetarët tonë, mirëmbajtje mesore për hasira të cilat e menaxhon ajo apo parking publike. Gjithashtu një rregullore e miratuar në kuvendin komunal në vitin 2023 nga kuvendi i komunës na mundëson të bëjmë një rritje të parkingeve të lejuar nga kuvendi.

Aktualisht kompania Ambienti menaxhon një pjesë të konsiderueshme të konsiderueshme të parkingjeve publike në qytetin tonë. Këtu përfshihen parkingu nëntësor i ndërtuar dhe mirë mbajtur sipas standartet e larta me një kapacitet prej 180 vendeve. Përveç tij, kompania menaxhon dhe parking përgjatë të gjithë rrugëve publike. Në fillim të funksionimit të kompanisë, numri i rrugëve të menaxhuari ishte më i madh, mirëpo për shkak të ndryshimit infrastrukturorë disa prej tyre janë kthyer vetëm në rrugë publike dhe pa parkingje. Aktualisht menaxhojmë në rrugë publike mbi 220 parking si dhe në hapësirat e tjera publike përfshirë parkingun e Gjon Recit i cili ka 136 prej tyre. Duke pa humbrë parasysh të gjitha këto fakte, besoj se kërkesa për rritjen e tarifave është e arsyeshme dhe interes të funksionimit të qëndrueshëm të kompanisë si dhe përmirësimit të me shërbimeve me sa më të mira. Një kërkesë e vazhdueshme e punëtorëve për rritjen e pagave do të na mundësojë që të që me rritjen e këtyre çmimeve do të na mundësojë rritjen e pagave. Aktualisht paga mesatare në kompani është 570€ kurse paga minimale e dini ju sot në korrik ka filluar me 500€ jemi detyruar t'i bëjmë këtë rritje. Shpresoj që nuk janë rritje të mëdhaja, janë të vogla dhe kërkojmë miratimin e tyre. Ju faleminderit.

Faleminderit drejtor.

Kush dëshiron të diskutojë?

Jehona Mustafa, Faleminderit i nderuar kryesues, të nderuar të pranishëm. Desha t'ia parashtroj drejtorit një pyetje. A ka pasur konsultim publik për këto dy pika 12in dhe 13in? Po lind te 13 edhe pse nuk është ardhur ende. Për ndryshimin domethënë për rregullorët për ngritjen e çmimit në parkingje dhe për pikën e 13 propozojmë vendim për miratimin e rregullores për menaxhimin e mbeturinave në komunën e Ferizajit. Me sa e di unë për çdo plotësim ndryshim i secilit dokument rregullore duhet me dalë në konsultim publik me udhëzimin administrativ për administratë të hapur. Pse nuk kanë pasur këto të dyja konsultim publik?

Faleminderit.

Amir Rexhepi Faleminderit kryesues. Nuk më pëlqej qysh e nisi drejtori tha që kanë rrit krejt çmime. Tash nëse me këtë logjikë ky funksionon është shumë gabim në atë vend që me shiku edhe me i zvogëlu çmimet këta domethënë veç i rrisin. Është gabim nëse nisemi nga logjika që privati e ka më shtrenjtë, hajde edhe ne ta bëjmë. Domethënë po i bëjmë konkurrencë parkingjeve private. Ë ju d aty mbikqyrjen edhe me i bërë kërkesa TK-së, me shku me i verifikuar ato pse i kanë bërë ato çmime, pse është starti 2€ që është më së shtrenjti në Ferizaj, në krejt Republikën e Kosovës, që ndoshta në Paris nuk kushton që kaq shumë. E tani ju po doni me i rritur edhe çmimet e parkingjeve publike që menaxhohen nga ambienti. A po don drejtor me i ndihmu ambientit? Q ta jap një ide shumë të thjeshtë, konkrete, veç borxjet paguaj ambientit dhe

ai funksionon hiç s'ka nevojë me i rrit çmimet e parkingjeve publike. Qato obligimet kontraktuale që i ka aktuale.

Edhe domethënë në rregull është kompania funksionon pa problem. Po ju nuk po keni mundësi me i kryer obligimet që i ka komuna ndaj kësaj kompanie. Tash po i shkoni po i rritni ë domethënë parkingjet. Ajo çka po më shqetëson është parkingi nën tokësor. Domethënë qysh shfrytëzohet te nëkimi domethënë ka qenë një herë e katër orë tash 1jë e gjys tre orë. Unë zakonisht e shfrytëzoj këtë parkingxh edhe tash kur të dal prej kët duhet me pagu më shtj. E kam këtë kartelën se po e shikojnë me vëmendje. Po e shoh po ka edhe kësi kartela që s'pagojnë prej kuvendarëve. Unë e kam këto që paguaj. Domethënë edhe domethënë tash e tutje kemi me paguar më shtrenjtë në këtë parking. Mendoj që kjo e rëndon edhe më tepër gjendjen e qytetarëve edhe ashtu të të varfër duke marrë parasysh inflacionin që po ballafaqohen ç ditë qytetarët e komunës së Ferizaj. Faleminderit.

Faleminderit Amir.

urdhëro. Brahim Osmani.

Faleminderit kryesues. E thë disa nga kolegët për çështje që është pru këtu në kuvend për më rrit çmimet. Unë e lexova arsytimin edhe u më çuditi për besë arsytimi i kësaj i kësaj kompanie që ka pruar. Sot vitet e fundit janë rritur kostot operative për menaxhimin e parakinjeve publike, përfshirë mirëmbajtjen infrastrukture, sinjalizimin horizontal dhe vertikal. pajisje teknologjike, shërbimet administrative dhe kostot e personelit. Unë nuk e di që ka ndryshuar diçka q aty drejtor. Paga minimale tjetër send është. Po për shembull nëse e ndryshon pagën minimale q është rritja për shembull e ke pasur 1 euro 8 orë tash e bën 1 ero tre orë pse për shembull nuk bën me dal me thënë kështu nëse ka 1 ero tetë orë bë me bë 1 ero gjashtë orë po 1 ero tre orë ti automatikisht privati sot kur të i ka 2€ për shembull për dy orë të ri unë kam dëgjuar që në qytet ka parkingje private që 2€ ka tetë orë ti në momentin që ja bën ështëu ti i b që ti më pak ke me pas punë në në parkingjet publike që janë pra ti po do me i barazu parkingjet publike me ato të privatit edhe tjetra thotë vërejtje tarifat nuk ndryshuar që tre vjet kupton është arsyetim i kotë nëse kompania ambienti nuk mundet me ja dalë për shkak që po thu që janë rrit këtu kastet operative për menaxhim nuk do me thënë që tash ti duhesh me çu edhe çka me b të parën që duhet me ja bë me ja bë qytetarëve të Ferizajit me thënë kam me ta arrit parkingxhin kam me të rrit mbeturinat kam me të rrit kam me lënë S patri q aty ku e ka mundësi q aty krejt ka me të mbyt ka me ta bë që kaq orën ka me t'i bë mbeturinat sa keni me bë tash ë tema tjetër vetë për shkak se kompanitë i keni shti në borxh jeni tu i falimentu pra nuk është që tash p edhe tjetra mua më shqetëson fakti bre që ky kuvend ka nxjerrë aksioner a e di bre që aksionerët e ambientit nuk kanë ardhë me i raportu këtij kuvendit kurrë as nuk kena raport as nuk e di gjendja q është në ambient përpos borxh borxh të dij s'ke nevojë me veta k hiç borxh janë të gjithë po a asnjëherë nuk ka ardhë janë zgjedhur aksionarët pa e ditë se kush ka me u zgjedh tash ne duhet me ardh me votu me i thënë qytetarët të Ferizajit qyre tash kena me ja bë në nënkallim një herë e katër orë ka enë tash një herë e gj tre orë në hapësirat publike që është kjë herë tetë orë tash një herë b tre orë kjo është rritje jashtëzakonisht e lartë mendoj që si grup parlamentar jemi kundër votë ritje nëse jeni desh konkurrencë privatit S'po e di kjo qeverisë është e çuditshme. Faleminderit shumë.

Faleminderit. Kryesuesi Urdhëroni.

Egzona Selimi.

Faleminderit kryesues. Atëherë të nderuar kolegë, kam një pyetje për drejtorin Sahiti.

Domethënë pse po rriten këto taksa kur parkingjet ekzistuese domethënë janë ekzistuese dhe cilësia e shërbimit nuk është rritur këtë për parking domethënë a është synimi i vetëm që rritja e hyrave për të zgjeruar administratën apo për të krijuar vende pune për njerëzit e afërt me

pushtetin nëse nuk ka një analizë të qartë që e arsyeton këtë rritje atëherë kjo është e padrejtë dhe e papranueshme në këtë kohë kur qytetarët po përballen me kosto gjithnjë e më të larta të jetës ku nuk është e drejtë që barra financiare t'u rëndohet edhe më shumë nuk është e drejtë që sa herë që po ka dështimin menaxhim, zgjidhja e vetme është rritja e barrës financiare për qytetarët.

Kryesuesi Faleminderit. Dikush tjetër?

Urdhëro Arian Imeri.

Faleminderit kryesues. Sa i përket kësaj pike, kërkesa është nga kompania për shkak të rritjes së kostove operative. diçka që e dimë të gjithë, sepse të gjithë këtu jemi duke jetuar dhe e dimë që është rritur energjia, derivatët, rogat e punëtorëve sepse shumë prej punëtorëve me rritjen e rrogës minimale kanë me pësu rritje. Pastaj dhe të gjitha mallrat dhe shërbimet që marrin kjo kompani nga operatorët e tjerë ekonomikë, pra janë rritur. Prandaj është kërkesë krejt normale nëse dëshirojmë me operu si duhet kjo ndërmarrje me i rrit edhe çmimet e shërbimit. Ne po shohim që janë rritur edhe parkingjet private të cilat janë me dy punëtorë maksimumi, një paradite dhe një pasdite dhe i kanë çmime 2 euro. Nuk mundemi me prit prej kompanisë publike me atë numër të punëtorëve që merren me parkingjet me i pas çmimet për gjysm e lirë. Edhe pse rritja prapë është më e lirë sesa te kompanitë private. Rritja e çmimeve është një situatë normale në shtetin tonë. Ne jemi shteti me inflacionin më të madh në regjion. E thashë edhe në komitetin për politikë dhe financa para dy ditë. Pra jemi shteti me rritjen më të madhe të çmimeve dhe normal që edhe Ferizaj është pjesë e këtij shteti dhe nuk mundet krejt Kosovën me u rrit çmimet dhe ne me mbet pa ndikuar nga kjo situatë. Edhe të paktën jo fer prej njerëzve që nuk kanë reaguar për asnjë rritje të çmimeve edhe të atyre elementare duke filluar prej bukës, ujit, vajit, kripit e çdo kripës e çdo artikulli tjetër elementar tash me reagu për parking nuk është diçka që ne e dëshirojmë rritjen e çmimeve. Është gjë shumë e keqe. Mirë kish me qenë të gjitha çmimet me u zbrit, sepse kjo është zinxhir. Nëse diçka, nëse disa çmime rriten ose zbriten të artikujve bazik, normal që pastaj kanë me pas ndikim në rritjen apo zbritjen e shumë shërbimeve dhe artikujve të tjerë.

